



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

**TEZË PROVIMI**  
**Moduli I- “Profesioni i Auditimit të Brendshëm”**

23 Maj 2026

**SEKSIONI 1- PYETJE ME ALTERNATIVA** Çdo pyetje vlerësohet me 1 (një) pikë

**1. Sipas përkufizimit të IIA-së, auditimi i brendshëm është:**

- a) Një funksion që meret vetëm me kontrollin financiar
- b) Një departament që zëvendëson menaxhimin
- c) Një funksion i fokusuar vetëm në zbulimin e mashtrimeve
- d) Një aktivitet i pavarur dhe objektiv që jep siguri dhe këshillim për të shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e organizatës**

**2. Kujdesi i duhur profesional kërkon që audituesit e brendshëm të:**

- a) Injorojnë dobësi të vogla të kontrollit të brendshëm
- b) Garantojnë që mashtrimi gjithmonë do të zbulohet
- c) Të fokusohen vetëm në auditime financiare
- d) Të aplikojnë kujdesin e duhur dhe gjykimin profesional**

**3. Një plan angazhimi duhet së pari të mbështetet në:**

- a) Preferencat personale të audituesit
- b) Oraret e audituesit të jashtëm
- c) Vetëm në kërkesat e punonjësve
- d) Vlerësimin e riskut të organizatës**

**4. Njësia e auditimit ka 12 auditues. Shumica janë caktuar në auditime me risk të ulët, ndërsa auditimet me risk të lartë shtyhen vazhdimisht për mungesë kohe. Çfarë tregon kjo?**

- a) Auditimi po ndjek standartet në mënyrë perfekte
- b) Audituesit kanë shumë eksperiencë
- c) Organizata ka kontroll të fortë
- d) Burimet janë të vendosura efektivisht dobët**

**5. Një auditues i brendshëm caktohet të auditojë procesin e prokurimit në bashki. Para 6 muajsh ai ka qënë pjesë e departamentit të prokurimit dhe ka kontribuar në hartimin e procedurave që do të auditohen. Cili është veprimi më i përshtatshëm?**

- a) Audituesi duhet të kryejë auditimin, por pa raportuar gjetje negative
- b) Audituesi mund të vazhdojë auditimin, sepse njeh mirë procesin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- c) Audituesi duhet të fokusohet vetëm në aspektet financiare të auditimit  
d) Audituesi duhet të deklarojë konflikt potencial dhe të zëvendësohet ose të mbikqyret nga një auditues tjetër
6. Auditimi i brendshëm në sektorin publik ndihmon menaxhimin në:
- Vendimmarrjen politike
  - Kontrollin e jashtëm
  - Eliminimin e rrezikut plotësisht
  - Arritjen e objektivave në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive
7. “Siguria” në auditim nënkupton:
- Kontroll total
  - Garanci absolute
  - Eliminim risku
  - Një nivel i arsyeshëm besimi
8. Cili është qëllimi kryesor i bazës konceptuale të auditit të brendshëm?
- Të përcaktojë pagat e audituesve
  - Të krijojë një kuadër parimesh dhe standartesh për ushtrimin e funksionit të auditit të brendshëm
  - Të zëvendësojë menaxhimin e organizatës
  - Të kontrollojë vetëm pasqyrat financiare
9. Menaxhimi është më së pari përgjegjës për:
- Për të realizuar angazhime siguridhënie të pavaruara
  - Për të mbajtur kontrole të brendshme efektive
  - Për aprovimin e pavarur të raporteve të auditimit
  - Për realizimin e auditimeve të jashtëme
10. Një auditues është duke rishikuar një iniciative strategjike për organizatën dhe identifikon risk potencial që në stadin fillestar. Kush është veprimi që duhet të kryejë auditin dhe që më së shumti shton vlerë në organizatë?
- Të presë derisa të implementohet
  - Të japë informacion proaktiv në lidhje me riskun si dhe rekomandime
  - Të mënjanojë përfshirjen
  - Ta delegojë te menaxhimi
11. Audituesi i brendshëm raporton kryesisht:
- Parlamentit
  - Publikut
  - Menaxhimit të lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

**d) Menaxhimit të lartë dhe palëve të interes**

**12. Risku vlerësohet për të:**

- a) Parandaluar çdo pasiguri
- b) Përcaktuar nivelet e pranueshme të riskut
- c) Rritur kontrollin në nivele të pranueshme**
- d) Ulur numrin e kontrolleve

**13. Një kontroll i tepërt mund të:**

- a) Të rrisë automatikisht efincencën dhe efektivitetin e organizatës
- b) Të krijojë një perceptim “më të lartë” sigurie mbi efektivitetin e kontrollit**
- c) Të eliminojë plotësisht mundësinë e gabimeve dhe mashtrimeve
- d) Të zëvendësojë nevojën për monitorim dhe menaxhim risku

**14. Mjedisi i kontrollit konsiderohet:**

- a) Element dytësor i sistemit të kontrollit të brendshëm
- b) Dokumentim i sistemit të kontrollit të brendshëm
- c) Themeli i sistemit të kontrollit të brendshëm**
- d) Teknikë auditimi

**15. Auditimi i brendshëm modern fokusohet:**

- a) Në risk dhe kontrolle financiare
- b) Në përputhshmëri dhe qeverisje
- c) Në risk, kontroll dhe qeverisje**
- d) Në risk dhe vlerë të shtuar

**SEKSIONI 2- PYETJE ME SHTJELLIM**

*Secila pyetje vlerësohet me 5(pesë) pikë*

**1. Kush janë parimet e përgjithshme të funksionit të auditit të brendshëm**

**Përgjigje:** Auditimi i brendshëm në sektorin publik ushtrohet dhe mbështetet mbi parimin e:

- a) **ligjshmërisë**, i cili nënkupton respektimin e Kushtetutës, legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
- b) **paanësisë**, i cili nënkupton pasqyrimin objektiv, transparent dhe të vërtetë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e njësisë publike të audituar, pa u ndikuar nga interesi personal ose pikëpamjet e të tretëve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- c) **integritetit**, i cili nënkupton ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë audituese;
- ç) **pavarësisë dhe objektivitetit**, i cili nënkupton pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e mendimeve e të gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimeve;
- d) **profesionalizmit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional**, i cili kërkon zbatimin e standardeve me kujdesin e duhur profesional, si dhe përpjekje të vazhdueshme për formimin e zhvillimin profesional, rritjen dhe përmirësimin e njohurive të çdo audituesi;
- dh) **kompetencës**, i cili nënkupton zotërimin dhe përdorimin e njohurive, aftësive dhe eksperiencës së duhur në ushtrimin e veprimtarisë audituese;
- e) **konfidencialitetit**, i cili nënkupton respektimin e fshehtësisë së të dhënave dhe dokumenteve të administruara gjatë auditimit si konfidenciale.

**2. Kush ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë organizative të njësisë së auditit të brendshëm? Ku përcaktohet kjo përgjegjësi? Cili është roli i Komitetit të Auditimit në lidhje me pavarësinë e strukturës organizative të njësisë së auditit të brendshëm**

**Përgjigje**

Sipas përcaktimeve të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik, është përgjegjësi e titullarve të njësive publike, sigurimi i pavarësisë organizative të njësive të auditimit të brendshëm. Komiteti i auditimit monitoron dhe këshillon titullarët si dhe mbështet njësitë e auditimit të brendshëm që të arrijnë pavarësinë e tyre organizative.

**3. Jepni disa dallime midis auditimit të brendshëm dhe inspektimit financiar**

**Përgjigje:** Dallimet midis auditimit të brendshëm dhe inspektimit financiar janë:

	<b>Inspektimi Financiar Publik</b>	<b>Auditimi i Brendshëm</b>
<b>Pozicioni</b>	Jashtë organizatës	Brenda organizatës
<b>Raportimi</b>	Ministrit të Financës	Titullarit të institucionit
<b>Aktiviteti</b>	Kërkesë, Informacion, Ankesë	Plan vjetor mbi bazë risku
<b>Qëllimi</b>	Zbulimi i paregullsive dhe dhënia e masave rregulluese, administrative, disiplinore, zhdëmtuese, kallzime penale	Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe performancës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

<b>Veprimtaria</b>	Ligjshmëri	Të gjitha aktivitetet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm për përputhshmëri dhe performance
<b>Drejtimi i rezultateve</b>	Në të shkuarën	Në të ardhmen
<b>Këndvështrimi</b>	Fokus te individët	Fokus te sistemet
<b>Përgjegjësitë për paregullsitë</b>	Zbulim, hetim, masa administrative dhe kallzime penale	Zbulim, parandalim, përmirësim

#### 4. Tregoni rolin e auditimit në sektorin publik

##### Përgjigje

Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë:

- duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;
- duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
  - identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
  - përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
  - ruajtjen e aseteve;
  - besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
  - kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
  - përbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
- duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
- duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

#### 5. Analizoni rëndësinë e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS) për profesionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik

##### Përgjigje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Standarde Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS) kanë rëndësi, përbëjnë bazën profesionale ofrojnë parime, kërkesa dhe udhëzime që ndihmojnë në kryerjen e detyrës së auditimit në mënyrë të njëtrajshme, efektive, profesionale, në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë forcimit të pavarësisë objektivitetit dhe etikës profesionale, krijimin e praktikave më të mira në përmirësim të proceseve të menaxhimit të riskut kontrollit dhe qeverisjes. Këto standarde janë të miratuara për zbatim nga Ministri përgjegjës për financat.

**SEKSIONI 3- USHTRIME** *Secila pyetje vlerësohet me nga 6(gjashtë) pikë*

**Ushtrimi 1**

Një organizatë publike ka miratuar një numër të madh procedurash dhe kontrollesh për proceset financiare dhe operative. Megjithatë, gjatë auditimit u konstatuan raste të vazhdueshme mashtrimi, pagesa të paautorizuara dhe manipulim dokumentacioni. Nga analiza paraprake rezultoi se: kontrollet ekzistojnë kryesisht vetëm në dokumentacion, menaxhimi nuk monitoron zbatimin e tyre, stafi shpesh anashkalon procedurat dhe nuk ka kulturë të fortë etike në organizatë.

**Kërkohe:**

1. Jepni të paktën 2 arsye të mundshme pse mashtrimet vazhdojnë pavarësisht ekzistencës së shumë kontrolleve.
2. Shpjegoni si ndikojnë këto problematika në efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**Përgjigje**

1. Dy arsye të mundshme
  - A) kontrollet ekzistojnë formalisht por nuk zbatohet në praktikë. Procedurat mund të jenë të dokumentuara por nëse nuk respektohen nga stafi dhe nuk monitorohen nga menaxhimi ato humbasin efektivitetin e tyre
  - B) menaxhimi ose stafi anashkalon kontrollet ekzistuese. Nëse drejtuesit tolerojnë shmangiet e procedurave ose vetë ndërhyjnë për të tejkaluar kontrollet, rritet ndjeshëm risku i mashtrimit dhe abuzimit.  
Arsye të tjera pranueshme: mungesa e etikës dhe kulturës së kontrollit, mungesa e ndarjes së detyrave, monitorimi i dobët, kontrolle të tepërta e burokratike që krijojnë vetëm perceptim sigurie, mungesë trajnimi dhe ndërgjegjësimit të stafit.
2. Këto problematika dobësojnë besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rrisin riskun e mashtrimit dhe gabimeve. Krijojnë kulture tolerance ndaj shkeljeve dhe ulin transparencën dhe llogaridhënien në organizatë  
Kontrollet bëhen joefektive kur ekzistojnë vetëm në letër dhe nuk funksionojnë realisht në praktikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

## Ushtrimi 2

Lidhni konceptin me përshkrimin duke argumentuar përgjigjen

Koncepti	Përshkrimi
1. Pavarësia	a. Veprimi me integritet dhe objektivitet
2. Standarde Profesionale	b. Udhëzime për kryerjen e auditimit
3. Etika	c. Liri nga ndikimet në auditim

## Përgjigje

1. Pavarësia me (c) liri nga ndikimet në auditim
2. Standardet profesionale me (b) udhëzime për kryerjen e auditimit
3. Etika me (a) veprimi me integritet dhe objektivitet

*Argumenti i lirë bazuar në gjykimin profesional të kandidatit*

## Ushtrimi 3

Lidhni situatën me konceptin duke argumentuar përgjigjet

Situata	Koncepti
1. Audituesit refuzojnë dhuratat nga të audituarit	a. Konfidencialiteti
2. Audituesit verifikojnë urdhër xhirimet përpara se të konkludojnë	b. Kujdesi i duhur profesional
3. Audituesit nuk përhapin të dhënat sensitive të pagesave	c. Objektiviteti
4. Organizata identifikon riskun nga hakërrimi i të dhënave	d. Menaxhimi i riskut
5. Audituesit qëndrojnë të paanshëm pavarësisht presionit	e. Integriteti

## Përgjigje

- 1- Audituesit refuzojnë dhuratat nga të audituarit lidhet me (e)
- 2- Audituesit verifikojnë urdhër xhirimet përpara se të konkludojnë lidhet me (b)
- 3- Audituesit nuk përhapin të dhënat sensitive të pagesave lidhet me (a)
- 4- Organizata identifikon riskun nga hakërrimi i të dhënave lidhet me (d)
- 5- Audituesit qëndrojnë të paanshëm pavarësisht presionit lidhet me (c)

*Argumenti i lirë bazuar në gjykimin profesional të kandidatit*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

**Ushtrimi 4**

Klasifikoni si auditim i brendshëm ose auditim i jashtëm disa aktivitete duke argumentuar përgjigjen.

Nr.	Aktiviteti	Klasifikimi	Argumentimi
1	Vlerësimi i efektivitetit të kontrollit të brendshëm në procesin e pagesave	A.B	Lidhet me vlerësimin e kontrollit, riskut dhe qeverisjes
2	Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit	A.J	Lidhet me opinion e pavarur mbi Pasqyrat financiare
3	Këshillimi i menaxhimit për përmirësimin e menaxhimit të riskut	A.B	Konsiderohet aktivitet konsulentë dhe shtim vlere për organizatën
4	Raportimi i rezultateve të auditimit Parlamentit	A.J	Auditimi i jashtëm raporton te Parlamenti ose te Publiku
5	Vlerësimi i pajtueshmërisë me procedurat e brendshme të institucionit	A.B	Fokus në përmirësimin e proceseve dhe respektimin e kontrolleve të brendshme
6	Auditimi i performancës mbi përdorimin e fondeve publike	A.J	Kryet zakonisht nga institucionet supreme të auditimit publik
7	Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e proceseve operative	A.B	Lidhet me funksionin këshillues dhe përmirësimin e operacioneve
8	Kryerja e auditimit për të dhënë siguri mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare	A.J	Fokus në besueshmërinë e informacionit financiar
9	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit brenda institucionit	A. B	Është pjesë e funksionit të ndjekjes së rekomandimeve dhe monitorimit të përmirësimeve
10	Raportimi publik mbi përdorimin e fondeve dhe llogaridhënien	A.J	Lidhet me llogaridhënien publike dhe transparencën

Argumenti i lirë bazuar në gjykimin profesional të kandidatit

**Ushtrimi 5**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Gjatë një auditimi në një institucion publik, u konstatua se audituesit e brendshëm përfshiheshin në miratimin e procedurave operative dhe financiare. Një auditues kishte marrë pjesë në vendimmarrje për procesin e prokurimit që më pas e auditoi vetë. Menaxhimi kërkonte nga njësia e auditimit të mos raportonte disa dobësi të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet e auditimit nuk dokumentoheshin në mënyrë të plotë në raportet përfundimtare.

**Kërkohet:**

1. Identifikoni cilat parime dhe kufizime të funksionit të auditimit të brendshëm janë cenuar në këtë rast.
2. Përshkruani të paktën 3 përgjegjësi të audituesit të brendshëm sipas Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

**Përgjigje**

1, Parimet dhe kufizimet e cënuara janë:

- a) Pavarësia dhe objektiviteti i auditimit të brendshëm
- b) Ndarja ndërmjet funksionit auditues dhe përgjegjësi operative
- c) Integriteti dhe profesionalizmi i audituesit
- d) Si dhe kërkesa për raportim të plotë dhe të paanshëm të gjetjeve të auditimit

2.Përgjegjësitë e AB sipas Ligjit janë:

- a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- ç) të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- d) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- dh) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- e) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHE E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

**SEKSIONI 1- RASTE STUDIMI** *Secila pyetje vlerësohet me nga 10(Dhjetë) pikë*

**Rasti 1**

Një bashki ka nisur një projekt të madh për rikonstrukcion rrugësh me financim nga buxheti i shtetit dhe donatorë ndërkombëtarë. Njësia e auditit të brendshëm ka vetëm dy auditues aktivë, ndërsa njëri prej tyre është pa eksperiencë në auditimin e projekteve infrastrukturore.

Gjatë auditimit evidentohen:

- Pagesa të kryera pa dokumentacion të plotë
- Vonesa në realizimin e kontratave
- Mungesë monitorimi të riskut nga menaxhimi
- Mospërputhje midis progresit fizik dhe raportimit financiar

Në të njëjtën kohë drejtuesi financiar kërkon që auditimi të kufizohet vetëm në shqyrtimin e dokumentacionit financiar dhe jo në aspektet operative të projektit

**Tregoni:**

Cili veprim është më në përputhje me praktikat profesionale të auditimit të brendshëm?

- a) Audituesit duhet të kufizohen vetëm në dokumentacionin financiar sepse aspektet operative nuk janë pjesë e auditimit të brendshëm
- b) Njësia e auditit duhet të refuzojë auditimin për shkak të mungesës së eksperiencës së stafit
- c) Drejtuesi i njësisë së auditit të brendshëm duhet të vlerësojë nevojën për ekspertizë dhe të sigurojë mbulim të mjaftueshëm të risqeve financiarë dhe operative
- d) Auditimi duhet të fokusohet vetëm në vonesat e projektit sepse ato janë problem më i dukshëm
- e) Raporti duhet të shmangë konstatimet mbi menaxhimin e riskut për të mos krijuar konflikt me drejtuesit

**Përgjigje**

- a) Veprimi që është në përputhje me praktikat profesionale të auditimit të brendshëm *“Drejtuesi i njësisë së auditit të brendshëm duhet të vlerësojë nevojën për ekspertizë dhe të sigurojë mbulim të mjaftueshëm të risqeve financiarë dhe operative” (alt c)*

Argumenti i lirë bazuar në gjykimin profesional të kandidatit.

**Rasti 2**

Në një institucion publik, njësia e auditimit të brendshëm kryen një auditim mbi procesin e menaxhimit të riskut. Gjatë analizës, audituesi vëren se organizata nuk ka një proces të formalizuar për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Menaxhimi merr vendime kryesisht mbi bazë përvojë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

dhe jo mbi analiza të strukturuar. Nuk ekziston dokumentim i riskut dhe monitorimi i tij është i kufizuar. Në disa raste, vendime të rëndësishme janë marrë pa vlerësuar ndikimin e mundshëm negativ. Menaxhimi nuk e konsideron këtë si problem, pasi proceset funksionojnë “praktikisht mirë”.

**Kërkesa: A paraqet kjo situatë një dobësi në qeverisje dhe menaxhim risku? Argumentoni dhe përcaktoni çfarë duhet të rekomandojë auditimi.**

**Përgjigje:**

Në këtë rast mungesa e një sistemi formal të menaxhimit të riskut përben një dobësi të rëndësishme në sistemet e qeverisjes. Vendimmarrja pa analiza të strukturuar rrit probabilitetin e gabimeve dështimeve.

Audituesi duhet të theksojë se vlerësimi i menaxhimit të riskut është një nga komponentët kryesor të auditimit të brendshëm. Ai duhet të rekomandojë krijimin e një procesi formal për identifikimin dhe monitorimin e risqeve. Kjo do të ndihmojë njësitë të përmirësojnë cilësinë e vendimeve dhe të arrijë objektivat në mënyrë me efektive.

**Rasti 3**

Në një institucion publik, auditimi i brendshëm vlerëson procesin e komunikimit të rezultateve të auditimit. Konstatohet se raportet e auditimit nuk shpërndahen gjithmonë në kohë dhe nuk ndiqen rekomandimet. Nuk ka sistem të strukturuar për monitorimin e zbatimit të planeve të veprimit. Menaxhimi shpesh nuk merr masa për zbatimin e rekomandimeve. Si rezultat, problemet e identifikuar vazhdojnë të ekzistojnë. Kjo ndikon në efektivitetin e auditimit të brendshëm.

**Kërkesa: A është efektiv funksioni i auditimit të brendshëm në këtë rast? Argumentoni duke analizuar ndjekjen e rekomandimeve.**

**Përgjigje**

Mungesa e ndjekjes së rekomandimeve dobëson efektivitetin e auditimit të brendshëm. Auditimi nuk përfundon me raportimin por me zbatimin e masave korigjuese. Audituesi duhet të theksojë rëndësinë e monitorimit të planeve të veprimit rekomandimet duhet të përfshijnë krijimin e një sistemi ndjekjeje. Kjo ndihmon në përmirësimin e performancës dhe reduktimin e risqeve.